



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 20.12.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti AKK–DPKI-06-4186/22, për zyrtarin e lartë z. Avni Ramadani, Kryesues i Bordit të NPQ “Kompania për Menaxhimin e Deponive” SH.A., për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për z. Avni Ramadani, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit lidhur me emërimin e z. Avni Ramadani nga Qeveria e Republikës së Kosovës në pozitën Kryesues i Bordit të NPQ “Kompania për Menaxhimin e Deponive” SH.A. (në vijim: KMDK), derisa i njëjti është në proces gjyqësor si palë paditëse me këtë ndërmarrje.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-02/4471/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Avni Ramadani lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç’rast z. Avni Ramadani është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket dyshimit për konflikt të interesit lidhur me emërimin e tij Kryesues i Bordit të KMDK-së, derisa ka një kontest gjyqësor në zhvillim e sipër në gjykatë me këtë ndërmarrje.

Në takimin e mbajtur dhe përmes dokumentacionit të dorëzuar në Agjenci, z. Avni Ramadani ka sqaruar dhe ka paraqitur argumentet e tij sa i përket dyshimit për konflikt të interesit në lidhje me emërimin Kryesues i Bordit të KMDK-së dhe kontestin gjyqësor që ka me ndërmarrjen në fjalë. I njëjti ka theksuar dhe ka paraqitur dëshmi se, *kontesti gjyqësor me KMDK-në është akoma nëpër procedura gjyqësore, lidhur me një padi të vitit 2014, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së tij të punës si Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK-së, si dhe në këtë kontest, që nga fillimi e ka angazhuar për përfaqësim një avokat. Tutje, z. Avni*

Ramadani ka sqaruar se Bordi Drejtues i KMDK-së, Kryesues i të cilit është emëruar, nuk është bord ekzekutiv, pra nuk ka kompetenca ekzekutive në KMDK, andaj nuk ka mundësi që bordi të ketë ndërlidhje të kompetencave me zbatimin e ndonjë vendimi (eventual) të gjykatës në (dis)favor të tij, në raport me KMDK. Sipas deklaratës së tij, kompetenca ekzekutive në KMDK ka Kryeshefi Ekzekutiv.

Nga kërkesa e raportuesit të rastit për iniciimin e procedurës së hetimit administrativ dhe dokumentet e bashkangjitura, takimi i mbajtur dhe dokumentacioni i dorëzuar në Agjenci nga z. Avni Ramadani, Agjencia ka konstatuar gjendjen si në vijim:

Me Vendimin nr. 005/07-09, i datës 06.07.2009, të Bordit të Drejtorëve të KMDK-së, z. Avni Ramadani është emëruar Kryeshef Ekzekutiv i KMDK-së, të cilën pozitë e ka ushtruar deri në Vendimin nr. 11/06-11, i datës 29.06.2011, të Bordit të Drejtorëve të KMDK-së, me të cilin është aprovuar kërkesa për dorëheqje e z. Avni Ramadani, nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK-së.

Pas kësaj, me Vendimin nr. 14/06-11, i datës 29.06.2011, të Bordit të Drejtorëve të KMDK-së, z. Avni Ramadani është emëruar në pozitën Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK-së, të cilën pozitë e ka ushtruar deri në Vendimin nr. prot. 11/624, i datës 25.11.2011, të Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK-së, me të cilin z. Avni Ramadani i është shqiptuar masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në pozitën Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv.

Kontesti në gjykatë ndërmjet z. Avni Ramadani dhe KMDK-së është duke u zhvilluar në bazë të padisë së vitit 2014, të parashtruar përmes përfaqësuesit të tij, për anulimin e vendimit të lartëcekur, me kërkesën për kthim në punë (pozita Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv) dhe kompensim.

Ndërkohë, me Vendimin nr. 12/96, i datës 14.09.2022, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Avni Ramadani është emëruar Kryesues i Bordit të KMDK-së.

Në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që është konstatuar se emërimi i z. Avni Ramadani në pozitën Kryesues i Bordit të KMDK-së dhe ushtrimi i kësaj detyre, ndërkohë që me këtë ndërmarrje ka një kontest gjyqësor në gjykatë duke u zhvilluar nga viti 2014, apriori nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI-së.

Kjo për faktin se, vetëm kontesti gjyqësor ndërmjet z. Avni Ramadani (tani Kryesues i Bordit të KMDK-së) dhe KMDK-së, nuk është element që përbënë ndonjë ndalesë, pengesë apo papajtueshmëri më ushtrimin e funksionin publik, *përderisa* z. Avni Ramadani, në cilësi të Kryesuesit të KMDK-së nuk ndërmerr ndonjë veprim zyrtar përkatësisht tërhiqet nga çdo diskutim dhe/apo vendimmarrje të KMDK-së, që lidhet me rastin e tij në gjykatë.

Së këndejmi, qëllim që në të ardhmen të shmangët mundësia eventuale e konfliktit të interesit, që lidhet me çfarëdo faze të vendimmarrjes për çështjen e kontestit të z. Avni Ramadani me KMDK-në, i njëjti duhet të ketë parasysh konfliktin "*rast për rast*" të interesit, ashtu që është i obliguar ta deklaroj dhe të tërhiqet nga (të gjitha fazat) vendimmarrja, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 17 të LPKI, si në vijim:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së



interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar. [...]

Pra, duke i marrë për bazë të gjitha ato që u thanë më lartë dhe pa e paragjykuar vendimin e gjykatës për kontestin ndërmjet z. Avni Ramadani dhe KMDK-së, Agjencia kërkon që zyrtari në fjalë të shmang çfarëdo përfshirje në vendimmarrje (në të gjitha fazat) apo ushtrim të rolit mbikëqyrës/drejtuës, në raport me kontestin që ka me KMDK-në për çështjen e tij.


Përveç kësaj, gjatë trajtimit të rastit Agjencia, në bazë të regjistrimit për deklarimin e pasurisë për vitin 2021 nga zyrtari i lartë z. Avni Ramadani, ka gjetur se i njëjti ka deklaruar se mbanë edhe pozitën Menaxher i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse në Ndërmarrjen Publike Lokale “Trafiku Urban” SH.A. në Prishtinë, por ka konstatuar se kufizimi i përcaktuar me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së me të cilin përcaktohet se: “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare [...]”, nuk vlenë në këtë rast, sepse ndërmarrja NPL “Trafiku Urban” SH.A. në Prishtinë, ka status të ndërmarrjes publike dhe nuk është *person juridikë privatë* në kuptim të dispozitës në fjalë.

Agjencia ka shqyrtuar këtë rast, në kuadër të pretendimeve të raportuesit të rastit, vetëm në aspekt të vlerësimit nëse paraqet konflikt të interesit emërimi i z. Avni Ramadani në pozitën Kryesues i Bordit të KMDK-së, ndërkohë që i njëjti ka një kontest gjyqësor me KMDK-në. Ndërsa, pretendimet tjera që lidhen me (mos)plotësimin (eventual) e kriterëve dhe kushteve të kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale sipas legjislacionit të ndërmarrjeve publike për këtë pozitë nga z. Avni Ramadani, nuk kanë qenë objekt trajtimi sepse janë jashtë kornizave të LPKI-së dhe jashtë mandatit të Agjencisë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

